



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008, të nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2023, miratoi këtë

V E N D I M

1. **Shfuqizohet** Rregullorja nr. 01-431/04-0253531/17, dt. 10.10.2017, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011.
2. **Shfuqizohet** neni 4 "Tarifat në transaksion të pronës" i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-431/04-227555/23, më 01.12.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci



Meqenëse Vendimi, nr. 01-435/02-257523/22, dt. 25.11.2022, të miratuar në Kuvendin e Kryeqytetit, lidhur me lirimin e obligimit të tarifës në transaksionin e pronës, është me afat të caktuar dhe ky afat do të kalojë më 31.12.2023.

Propozojmë që tarifa për transaksion të pronës të shfuqizohet me këtë

Arsyetim

Duke pasur parasysh se qytetarët e Kryeqytetit Prishtina po ballafaqohen me shumë probleme socio-ekonomike në zhvillimin e jetës normale, në këtë standard jetësor jo të mjaftueshëm është e lartë kjo taksë, e cila e rëndon edhe më shumë gjendjen ekonomike të qytetarëve.

Një prej sfidave ishte pagesa e tarifës për transaksion në pronë, në vlerë prej 150 € dhe atë për një njësi objekt deri në 100 m² dhe një njësi për parcelë deri në 10.000 m², e që është derivat i kontratës së shitblerjes, e aq më shumë rënduese ishte pagesa e procesit të trashëgimisë (pronës së paluajtshme), si dhe akteve të tjera juridike me të cilën bëhet bartja e pronës, siç janë dhurata, falja e të ngjashme.

Fakti që shumë qytetarë nuk e kanë regjistruar pronën e paluajtshme në librat kadastral është për shkak të kësaj pagese, pasi që në një akt juridik për një pronë të paluajtshme, i është llogaritur dy e me shumë njësi.

Sipas vlerësimit të Drejtorisë së Financave, me rastin e pezullimit të taksës në transaksion sipas vendimit të cekur si më lart, nga janari i vitit 2023, iu është dhënë mundësia qytetarëve që të bëjnë rregullimin pronave në regjistrin kadastral, e që besojmë se ka pasur efekte pozitiv. Sipas informatave që kemi në dispozicion, për periudhën janar-qershor 2023, janë proceduar 4123 kërkesa për bartje, apo shprehur në përqindje 63% më shumë se në të njëjtën periudhë kohore të vitit paraprak 2022.